



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr. 21 Datë 25. 3. 2010

MBI SHTYRJEN E AFATIT TE KONTRATAVE TE SHERBIMIT TE
TRANSPORTIT QYTETES NE QYTETIN E KORCES

Keshilli i Bashkise i qytetit te Korces ne mbledhjen e tij te dates se sotme pasi mori ne analize relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Menaxhimit te Kontratave dhe Drejtoria Juridike "Mbi shtyrjen e afatit te kontratave te sherbimit te transportit qytetes ne qytetin e Korces " mbeshtetur ne ligjin nr.8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" Ligjin nr. 8308 date 18.03.1998 " Per transportet rrugore ", i ndryshuar , Udhezimin nr. 15 , date 24.07.2007 , " Per kriteret dhe procedurat e leshimit te licensave , certifikatave dhe autorizimeve per ushrimin e veprimtarise ne transportin rrugor "i ndryshuar, Vendimin e Keshillit Bashkiak te Qytetit te Korces nr. 103 , date 24.12.2004 , " Mbi percaktimin e kriterëve per perzgjedhjen nepermjet konkurimit te subjektit qe do te kryeje transportin qytetes ne qytetin e Korces" per linjen nr.1, Vendimin e Keshillit Bashkiak te Qytetit te Korces nr. 22 , date 30.03.2005 , " Mbi percaktimin e kriterëve per perzgjedhjen nepermjet konkurimit te subjektit qe do te kryeje transportin qytetes ne qytetin e Korces" per linjen nr.2, Vendimin nr. 2 date 30.04.2005 te Komisionit te Vleresimit te Transportit Qytetes prane Bashkise Korce dhe Vendimin nr.1, date 01.03.2005 te Komisionit te Vleresimit te Transportit Qytetes prane Bashkise Korce, ne kompetencat qe ka si dhe mbas diskutimeve te anetareve :

VENDOSI

- I. Te miratoje shtyrjen e afatit te kontratave te sherbimit te transportit qytetes ne qytetin e Korces deri ne lidhjen e kontrates se re .
- II..Per zbatimin e ketij Vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Menaxhimit te Kontratave.
- III. Ky Vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI

Gjergji PENDAVINJI